

100 VJET – SHTET
DREJTËSIA KUSHTETUESE NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS

Fjalim Hyrës
9 Maj 2013 – Tiranë

Nga Bashkim Dedja
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Të dashur miq,
Të dashur pjesëmarrës,
Të dashur ish-anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Ndihem i nderuar të jem sot mes anëtarëve dhe ish-anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët ndër vite kanë kontribuar me punën dhe veprimtarinë e tyre, drejt orientimit të drejtësisë kushtetuese shqiptare.

Ky aktivitet i organizuar me rastin e Ditës së Drejtësisë përkon dhe me 100 – vjetorin e krijimit të shtetit shqiptar, prandaj dhe unë vlerësoj, të ndalem shkurtimisht në aspektet kryesore historike të formësimit të shtetit shqiptar dhe akteve kushtetuese sipas periudhave.

Në Shqipëri, pas 22 vjetësh ndryshimi të sistemit qeverisës, sigurisht që mund të flitet shumë për drejtësinë kushtetuese si koncept në zhvillim, me zgjerimet dhe ngushtimet e sferës së juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Por, kur ka lindur drejtësia kushtetuese në Shqipëri? Cilat kanë qenë aktet e para të qeverisjes dhe a kanë pasur formën e një Kushtetute të mirëfilltë? Po organe të gjyqimit kushtetues? A ka pasur para viteve 90’, formësim apo zhvillim të saj?

Historia na tregon se prej ligjeve të vjetra kujtohet **Kanuni**, një lloj “kushtetute” e respektuar nga një pjesë e mirë e shqiptarëve për shekuj. Shquhet Kanuni i Lekë Dukagjinit, që sipas shënimeve u kodifikua në shek. XV nga princi shqiptar me po të njëjtin emër. Kanuni i Lekë Dukagjinit u ka shërbyer shqiptarëve për ta ruajtur vetëqeverisjen e tyre si dhe për të ushtruar sado pak një pushtet demokratik. Sipas Kanunit, vendime të rëndësishme merreshin nga kuvendet e pleqve.

Në valën e Rilindjes Kombëtare të shek. XIX, shqiptarët themeluan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878) dhe ndërkohë krijuan një qeveri të përkohshme për vilajetet shqiptare. **Kanuni i Lidhjes**, me emrin *Kararname* (Akti i Vendimeve) sanksionoi formimin e Lidhjes, si organizatë politike shqiptare dhe përcaktoi detyrat e saj më të ngutshme. Ai shprehte synimet vetëqeverisëse të shqiptarëve. Lidhja e Prizrenit e vishte veten dhe komitetet e saj, me funksione kushtetore, të veçuara nga ato të Stambollit (neni 14), të cilat e dobësonin autoritetin e Portës së Lartë në Shqipëri.

Shteti Shqiptar filloi jetën e pavarur që nga viti 1912, pikërisht pas **aktit kushtetues të shpalljes së pavarësisë** nga Kuvendi Kombëtar i mbledhur në Vlorë. Katër vendime të rëndësishme të Kuvendit ishin format e para kushtetuese:

-Të bëhet Shqipëria më vete dhe e lirë,

-Nën një qeveri të përkohshme,

-Të zgjidhet një pleqësi për kontroll të qeverisë,

-Të dërgohet një komision në Evropë, për të mbrojtur çështjen shqiptare në mbretëritë e mëdha të Evropës¹.

Me qeverinë e Vlorës, edhe pse vetëm 14 muaj jetëgjatësi, spikati legjislacioni kushtetues si dhe u formësuan disa degë të tjera të së drejtës.

Më 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, përcaktoi dhe formën e qeverisjes, ku Shqipëria shpallej një principatë autonome, sovranë dhe trashëgimore, që vendosej nën garancinë e gjashtë Fuqive të mëdha.

Me njohjen e pavarësisë së Shqipërisë nga fuqitë e mëdha evropiane, u arrit marrëveshja për formën monarkike të qeverisjes. Sipas **Statutit Organik** ose kushtetutës së atëhershme (1914), Shqipëria ishte **mbretëri kushtetuese** me në krye Mbretin Vid. Ky statut mund të konsiderohet një akt me karakter kushtetues, liberal, por jo demokratik. Statuti shquhej për kompetenca të gjera të Mbretit si dhe për kontrollin e Asamblesë ligjvënëse nga ana e mbretit, duke mos i dhënë frymëmarrje parimit të ndarjes së pushteteve². Mirëpo, kjo

¹ Anastasi Aurela.; "Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri", 1912-1939, Shtëpia botuese Pegi, 2007, fq.16.

² Ibid, fq.24 -41

kushtetutë nuk pati jetë të gjatë për shkak të rebelimeve të brendshme kundër Vidit në njërin anë, si dhe për shkak të Luftës së Parë Botërore në anën tjetër.

Në vitin 1920 kemi miratimin e aktit me karakter kushtetues të quajtur **Statuti i Lushnjës**, nga Kongresi i Lushnjës, i cili afirmonte parimet kryesore kushtetuese të shtetit shqiptar³. Ky statut u plotësua me **Statutin e shtetit shqiptar** (1922) që njihte formën monarkike të qeverisjes dhe afirmonte ndarjen e tre pushteteve, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Më 1925 u shpall **Ligji Themeltar i Republikës Shqiptare**, që përbën dhe Kushtetutën e parë Shqiptare. Kjo republikë, e bazuar në modelin e Republikës së Tretë Franceze (1870-1940), ishte parlamentare, me në krye një president të fuqishëm, që ishte kreu i shtetit si dhe shef i ekzekutivit (qeverisë). Pushteti ligjvënës ndërkaq i takonte dy dhomave të parlamentit, asaj të deputetëve dhe Senatit. Me këtë ligj u ruajtën parimet e ndarjes së pushteteve dhe sovranitetit.

Më 1928, Shqipëria shpallet mbretëri demokratike e parlamentare nga Asambleja Kushtetuese, duke miratuar dhe **Statutin themeltar të Mbretnisë Shqiptare**. Ky statut rregullonte pushtetin gjyqësor dhe formalisht e sanksiononte si një degë të pavarur⁴. Organi ligjvënës përbëhej prej një dhome, ndërsa pushteti ekzekutiv i takonte kreut të shtetit, Mbretit, dhe kabinetit të përbërë nga kryeministri dhe ministrat. Me pushtimin fashist dhe largimin e Mbretit Zog nga Shqipëria, *de facto*, kjo kushtetutë merr fund.

Më 1946, Asambleja Kushtetuese e Shqipërisë e dalë nga zgjedhjet e vitit 1945, shpall Shqipërinë Republikë Popullore dhe hyn në fuqi **kushtetuta e re**, e cila përcaktoi dhe Republikën si formë qeverisjeje. Me këtë kushtetutë shprehej baza e gjerë shoqërore e shtetit të demokracisë popullore. Asambleja Kushtetuese që më pas u shndërrua në Kuvend Popullor ishte organi më i lartë i shtetit. U sanksionua uniteti i pushtetit, i përqendruar në organet përfaqësuese, si Kuvendi Popullor dhe këshillat popullore, që ushtronin kompetenca legjislative dhe ekzekutive. Sa i përket gjyqësorit, përcaktohej se Drejtësia në Republikën Popullore të Shqipërisë jepej nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat popullore dhe nga gjykatat ushtarake dhe se Gjykatat ishin të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre (neni 80). Gjykata e Lartë ishte organi më i lartë i drejtësisë (neni 81).

Më 1976 aprovohet **një kushtetutë** tjetër, që përcakton Shqipërinë si “Republikë Popullore Socialiste”. Me këtë kushtetutë, u krijuan gjykatat popullore, në krye të të cilave qëndronte

³ *Ibid*, fq.48

⁴ *Ibid*, fq.88

Gjykata e Lartë (neni 101). Sigurisht që pushteti ishte i centralizuar në ekstrem, ekzistonte shteti monopartiak, dhe as nuk mund të flitej për drejtësi kushtetuese gjatë kësaj periudhe, e cila në themelet e saj ka ndarjen e pushteteve dhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Më 1991, me pranimin e sistemit shumëpartiak, u miratua një kushtetutë e përkohshme, ose ndryshe ***Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese***.

Orientimi demokratik i shtetit kërkonte kryerjen e një reforme institucionale të thellë, e cila duhet t'i hapte rrugë shndërrimeve për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Parimet themelore që udhëhoqën këto ndryshime demokratike u shpallën fillimisht me ligjin nr.7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe më pas me ligjin nr.7561 datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 datë 29.04.1991 Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në kuadër të këtyre ndryshimeve u krijua edhe Gjykata Kushtetuese, si një nga institucionet më të rëndësishme për garantimin e rendit të ri kushtetues. Që në fillim ky institucion u konsiderua nga ligjvënësi si autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

Ligji kushtetues “Për dispozitat kryesore kushtetuese” kërkonte nxjerrjen e akteve të tjera për rregullimin e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese. Më 15.07.1998 Kuvendi miratoi ligjin nr.8373 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili krijoi bazën ligjore për çështjet e veprimtarisë së Gjykatës.

Më 1998, hyri në fuqi Kushtetuta, në të cilën Gjykata Kushtetuese zuri përsëri një pozitë institucionale të rëndësishme. Gjithashtu, ajo solli dhe ndryshime në mënyrën e caktimit të anëtarëve, të kompetencave dhe subjekteve që e vënë atë në lëvizje. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Gjithashtu, Kryetari emërohet nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit.

Më 10.02.2000, Kuvendi miratoi ligjin nr.8577 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili u hartua me ndihmën e Komisionit të Venecias “Demokracia përmes ligjit”. Ky ligj rregullonte çështje të tilla, si mënyrën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin paraprak, procedurat e gjyqimit, statusin dhe mandatin e gjyqtarit.

Në etapën e parë, 1992-1998, veprimtaria e GJK është mbështetur në Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Në këtë etapë, edhe pse pa përvojën e duhur, kjo Gjykatë arriti të vendosë gurët e parë të themelit të një praktike kushtetuese, që u konsolidua më pas, në etapën e dytë pas vitit 1998, me miratimin e Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka një juridiksion të veçantë, për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1). Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124/2).

Drejtësia kushtetuese është institucioni dhe teknika që garanton respektimin e hierarkisë së burimeve të së drejtës dhe me këtë, supremacinë e normës kushtetuese, si norma eprorë në një sistem juridik. Nëpërmjet zbatimit të dispozitave kushtetuese sigurohet epërsia e Kushtetutës, jo vetëm në një sistem normativ, por edhe më gjerë në sistemin e institucioneve dhe praktikave shtetërore, politike e sociale.

Kontrolli kushtetues i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese (*rishikim i përqendruar*), është forma më e mirë e gjetur, përgjithësisht për sistemin evropian, për të siguruar kushtetutshmërinë funksionale të organeve shtetërore, me qëllimin e vetëm për të mos i lënë vend arbitrariteteve dhe anarkisë, me pasoja të drejtpërdrejta tek individët, dhe tek niveli i demokracisë në vend. Megjithatë, në praktikë situata është më e komplikuar. Kjo varet nga kultura politike, juridike, stadi ekonomik dhe shoqëror, e të tjerë faktorë të një vendi të caktuar. Këta faktorë shpjegojnë dhe diferencat mes vendeve me demokraci të konsoliduar nga vendet me demokraci në zhvillim, edhe pse në nivelin juridiko-formal mund të jenë palë e të njëjtave konventa dhe akte ndërkombëtare. Në këtë kontekst, mund të kuptohet dhe sfida e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, si promotore e realizimit të drejtësisë kushtetuese.

Ju faleminderit!